



VENDIM

Nr. 40, Datë 12.04.2016

**MBI
LICENSIMIN E SHOQËRISË “BALLENJA POWER
MARTANESH”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5, pika 1 gërma “f”; 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9 gërma ‘a’, gërma ‘b’ dhe gërma ‘c’ është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “BALLENJA POWER MARTANESH” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 40, Datë 12.04.2016

**MBI
LICENSIMIN E SHOQËRISË “BALLENJA POWER
MARTANESH”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____